



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 2609/prot.
12

Vlorë, më 06.03 2024

VENDIM

Nr. 15, Datë, 26.2 2024

“PËR KRIJIMIN E SHOQËRISË “MARKATA E PESHKUT VLORE” SH.A SI PERSON JURIDIK NË PRONËSI TË BASHKISË VLORE DHE MIRATIMIT TE STATUTIT”

Bazuar në Ligjin nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 8, pika 2, neni 9/1, pika 1/b dhe 7/a, neni 54, pika m, ne Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, në VKM nr.347 datë 22.05.2019 “Për përcaktimin e kushteve dhe të procedurave të transferimit të menaxhimit të infrastrukturës së peshkimit tek organizatat e peshkimit, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe subjektet private”, Në Urdhërin e Përbashkët nr.443, datë 6.10.2022 “Për përcaktimin e tarifave të autorizimit për peshkimin çlodhës-argëtues dhe tarifave për shërbimet që ofrohen nga organizatat e peshkimit” si edhe në relacionin e paraqitur nga Administrata e Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Vlorë:”

VENDOSI:

- 1) Krijimin e shoqërisë me emërtimin tregtar “MARKATA E PESHKUT VLORE” sh.a, shoqëri aksionere, e zotëruar në masën 100 (njëqind) % të kapitalit të shoqërisë nga Bashkia Vlorë me objekt veprimtarie, ofrimin e shërbimeve në fushën e zhvillimit ekonomik.Menaxhimin në përpunje me legjislacionin në fuqi për peshkimin në zonën e Markatës si dhe sigurimin e një mekanizmi për pjesëmarrjen në bashkëmenaxhimin e burimeve peshkore.
- 2) Shoqëria “MARKATA E PESHKUT VLORE” sh.a themelohet, organizohet dhe funksionon si shoqëri sh.a, në përputhje me parashikimet e ligjit nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar si dhe statutit bashkalidhur këtij vend
- 3) Kapitali fillestar për krijimin e shoqërisë “MARKATA E PESHKUT VLORE” sh.a, të jetë 3.500.000 lekë.

- 4) Bashkia Vlorë është ortaku i vetëm themelues, i cili zotëron 100 (njëqind) % të kapitalit themeltar të shoqërisë "MARKATA E PESHKUT VLORË" sh.a. të barabartë me një kuotë me vlerë të përgjithshme prej 3.500.000 lekë.
- 5) Shoqëria "MARKATA E PESHKUT VLORË" Sh.a. fillimisht të ketë selinë qendrore në adresën, Triport-Vlorë, Shqipëri.
- 6) Shoqëria "MARKATA E PESHKUT VLORË" sh.a. të zhvillojë aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar.
- 7) Pas miratimit të kërkesës për themelimin e shoqërisë aksionare themeluesi cakton Administratorin/Administratorët për herë të parë.
- 8) Efektet financiare për zbatimin e këtij vendimi, për krijimin e kapitalit fillestar të shoqërisë, në vlerën 3.500.000 lekë, përballohen nga buxheti i vitit 2024.
- 9) Bashkia Vlorë, Drejtoria e Finances, Buxhetit dhe Kontabilitetit angazhohet në mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit.
- 10) Bashkia Vlorë, nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, ndjek procedurat e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë "MARKATA E PESHKUT VLORË", sh.a. në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- 11) Të autorizojë Kryetarin e Bashkisë ose personin e deleguar prej tij, që të përfaqësojë Bashkinë Vlorë, në cilësinë e aksionarit të vetëm për kryerjen e të gjitha veprimeve të nevojshme për përgatitjen dhe nënshkrimin e akteve të themelimit të shoqërisë së re dhe regjistrimin e saj sipas legjislacionit në fuqi.
- 12) Bashkia Vlorë i siguron shoqërisë "MARKATA E PESHKUT VLORË" sh.a. nga inventari i saj i pronave të paluajtshme apo ambiente të tjera të kontraktura ndaj të tretëve, mjediset e nevojshme për fillimin e ushtrimit të veprimtarisë sipas objektit të saj.
- 13) Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Vlorë.
- 14) Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë sipas Ligjit Nr.139/2015 dt 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" neni 55 pika 6.



KRYETAR
Elpinqi Mërkuri